

**AKT I THEMELIMIT
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“AL MEDIC LAB” SH.P.K.**

Sot, në datën 24/01/2022, në qytetin e Tiranës, personi i mëposhtëm, vendos të themelojnë Shoqërinë “**Al Medic Lab**” Sh.p.k, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar duke nënshkruar këtë Akt Themelimi dhe Statut në bazë të vullnetit të tij të lirë dhe të plotë.

- 1) **Z. Anisa Vezuli**, atësia Ligor, amësia Anita, shtetase shqiptare, e lindur në Korçë, në datën 17/04/1991 dhe banues në Tiranë, Njesia bashkiake Nr. 2, Rruga “Mihal Grameno”, Nd. 78/4, H. 4, Ap. 44B, mbajtës i ID me nr. 035399440 dhe me numër personal J15417096V, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

me nënshkrimin e këtij akti dhe në përputhje me ligjin nr. 991, datë 14.04.2008, “*Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*” i ndryshuar, dhe legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë, personi i sipercituar, themelon një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e cila do të ushtrojë aktivitetin në përputhje me legjislacionin Shqiptar, Aktin e Themelimit dhe dispozitat e Statutit bashkëlidhur si Aneksin A, si pjesë integrale dhe thelbësore e këtij Akti Themelimi.

Neni 1 – Emërtimi dhe Forma e Shoqërisë

- 1.1 Shoqëria emërtohet “**AL Medic Lab**” Sh.p.k. dhe themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar (në vijim “**Shoqëria**”).
- 1.2 Shoqëria themelohet në bazë të legjislacionit shqiptar dhe do të ushtrojë aktivitetin në përputhje me legjislacionin Shqiptar, Aktin e Themelimit dhe dispozitat e Statutit.
- 1.3 Shoqëria ka vulën dhe logon e saj zyrtare.

Neni 2 – Selia

- 2.1 Selia e Shoqërisë është në adresën *Rruga Nacionale Librazhd - Elbasan, rregjistruar me nr. Pasurie 8/284-2, Volum 20, Faqe 111, zona kadastrale 2446, Librazhd, Shqipëri.*
- 2.2 Shoqëria mund të ketë zyra, degë, zyra përfaqësimi dhe agjenci si në adresa të tjera në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj.
- 2.3 Asambleja e Përgjithshme mund të çelë, transferojë dhe/apo mbyllë, si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj, degë dhe/ose zyra përfaqësimi. Ndërsa, Administratori i Shoqërisë mund të çelë, transferojë dhe/apo mbyllë, si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj, seli sekondare, filiale dhe/ose agjencive.

Neni 3-Objekti

- 3.1 Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:



- a) Laborator analizash klinik, biokimik, mikrobiologjik, gjenetik, etj.
 - b) Qendër mjekësore, shërbime mjekësore të ndryshme, etj.
 - c) Farmaci, tregëtimin e medikamenteve farmaceutikë etj.
 - d) Shitje syzezhe optike dhe dielli, xhama për syze optike dhe dielli, etj.
 - e) Importimi dhe eksportimi i aparaturave dhe pajisjeve elektro mjekësore tregëtimi me shumicë dhe pakicë, mirëmbajtja dhe furnizimi i tyre.
 - f) Çdo veprimtari tjetër që do të konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme për realizimin e qëllimit të Shoqërisë dhe që nuk bie ndesh me legjislacionin shqiptar në fuqi.
- 3.2 Për realizimin e objektit të veprimtarisë së saj, Shoqëria mund të kryejë gjithashtu, si aktivitet ndihmës dhe jo parësor, pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive ose ndërmarrjeve dhe ose entiteteve të tjera me objekt të ngjashëm, të afërt ose të lidhur me të vetin, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, si dhe çdo aktivitet tjetër të lejuar nga ligjet në fuqi.
- 3.3 Të gjitha veprimtaritë e përshkruara më sipër mund të zhvillohen si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj.
- 3.4 Shoqëria mund të bashkëpunojë dhe/ose blejë/përfitojë direkt ose indirekt pjesëmarrje, në shoqëri, ndërmarrje, agjenci apo sipërmarrje të tjera, të cilat kanë fushë veprimtarie të ngjashme.

Neni 4 – Kohëzgjatja e Shoqërisë

- 4.1 Shoqëria themelohet dhe ushtron veprimtarinë e saj për një kohëzgjatje të pakufizuar.
- 4.2 Shoqëria mund të priset në çdo moment me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 5 - Kapitali Themeltar dhe Ortakët

- 5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është **2.000.000** (dy milion) **LEKË** i cili është i ndarë në 1 (një) kuotë, për ortakun e Shoqërisë.
- 5.2 Kapitali i Shoqërisë zotërohet nga Ortakët e mëposhtëm:
1) Znj. Anisa Vezuli, zotëruese e 1 (një) kuote të Shoqërisë, me vlerë 2.000.000 Lekë (dy milion) Lekë, qe përfaqëson **100% (njëqind përqind)** të kapitalit themeltar, me të drejtë vote;
- 5.3 Kapitali themeltar është nënshkruar dhe shlyer plotësisht me kontribute në para nga Ortaku i vetem me themelimin e Shoqërisë.
- 5.4 Përgjegjësia e Ortakut të Shoqërisë shtrihet deri në shumën e kontributit të tji në kapitalin e Shoqërisë.



- 5.5 Shoqëria mund të marrë nga Ortaku/kët hua dhe financime në favor të saj, me apo pa pagesë, me ose pa detyrim rimbursimi në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- 5.6 Adresat e Ortakëve dhe administratorëve për marrëdhëniet e tyre me Shoqërinë, janë adresat që rezultojnë nga statuti ose akti i emërimit të tyre dhe ndryshimet nëse ka pasur më vonë.

Neni 6 – Transferimi i Kuotave

- 6.1 Kuotat e Shoqërisë mund të transferohen plotësisht ose pjesërisht në përputhje me procedurat e parashikuara në nenin 7 të Statutit të Shoqërisë.

Neni 7 – Administratori/ët

- 7.1 Shoqëria administrohet nga një ose më shumë Administratorë. Në rast se ka më shumë se një Administrator, Administratorët do të veprojnë bashkarisht përveçse kur parashikohet ndryshe në aktin e emërimit të tyre. Administratorët do të qëndrojnë në detyrë deri në shkarkim apo dorëheqje ose për një periudhë 5 (pesë) vjeçare.
- 7.2 Administratori/ët përfaqëson/jnë ligjërisht Shoqërinë. Administratori ushtron të gjitha fuqitë e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të Shoqërisë, në përputhje me nenin 95 të Ligjit nr.9901, datë 14 mars 2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, dhe vendimet e Asamblesë së Përgjithshme.
- 7.3 Administratori/ët mund të emërojë/në përfaqësues me prokurë speciale (“*ad negotia*”) për kryerjen e një akti ose kategori aktesh në kufijtë e tagrave që u janë dhënë atyre nga ligji në fuqi ose Statuti.
- 7.4 Si Administrator i parë është emëruar personi me të dhënat e mëposhtme:
➤ *Z. Dorian Vezuli, atesia Ligor, amësia Anita, shtetas shqiptar, i lindur në Korçë, në datën 25/05/1985 dhe banues në Tiranë, Njesia bashkiake nr. 2, Rruga “Gramoz Pashko” H. 1. Ap. 14, mbajtës i ID me nr. 034452420 dhe me numër personal I50525078W, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.*

Neni 8 – Dispozita të Fundit

- 8.1 Ky Akt Themelimi është hartuar në 4 (kater) kopje në Shqip.
- 8.2 Për çdo çështje që nuk rregullohet posaçërisht nga ky Akt Themelimi, do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar.
- 8.3 Z. Dorian Vezuli, atësia Ligor, amësia Anita, shtetas shqiptar, i lindur në Korçë, në datën 25/05/1985 dhe banues në Tiranë, Njesia bashkiake nr. 2, Rruga “Gramoz



Pashko” H. 1. Ap. 14, mbajtës i ID me nr. 034452420 dhe me numër personal I50525078W, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, autorizohet me anë të këtij akti që të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë “AL Medic Lab” Sh.p.k, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, si dhe të regjistrojnë Shoqërinë pranë autoriteteve fiskale, sigurimeve shoqërore, dhe tek të gjitha autoritetet shqiptare sikurse mund të kërkohet nga ligji i zbatueshëm në fuqi, përfshirë të drejtën për të nënshkruar aktet dhe dokumentet përkatëse në këto organe.

* * *

Znj. Anisa Vezuli

Anisa Vezuli
